



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura e III-të**

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja Nr. 25  
Prishtinë, më 12.05.2009  
Salla N-10 ora 10,00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Memli Krasniqi, Gani Buçinca, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi, Haset Cakolli dhe Mark Krasniqi.  
Munguan Enis Kervan dhe Dragan Dimiq.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesi i UNDP-së, OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga presidenca dhe mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.  
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

**Kryesuesi**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi debat lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës, se a ka ndonjë kërkesë për shqyrtim përveç propozimit për debat lidhur me Letrën e Bardhë të UNDP-së dhe propozimit për vizitat e anëtarëve të Komisionit në Drejtoritë Komunale të Arsimit.

Pasi nuk kishte propozime tjera, kryesuesi propozoi të vazhdohet me pikën e parë të rendit të ditës.

## **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Kryesuesi**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 21.04.2009 me disa plotësime.

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të Rinisë.**

**Agim Veliu**- kryetar e përkrahu miratimin në parim të projektligjit si një Ligj i rëndësisë së veçantë që rregullon fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes.

Komisioni lidhur me këtë projektligj do të caktojë edhe takime dhe dëgjim publik me të rinjtë me qëllim që të marrim sugjerimet nga ata. Me amendamentimin e këtij projektligji do të nxirren Rekomandimet e Komisionit për një ligj që rregullon fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes.

**Arsim Rexhepi** – tha se e përkrah në parim miratimin e projektligjit, ndërsa vërejtjet kanë të bëjnë me unifikimin e tekstit në gjuhën angleze dhe serbe me tekstin në gjuhën shqipe si dhe vërejtjet teknike.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me koston financiare, ky ligj duhet të definojë edhe vendet e punës së të rinjve nëpër komuna

Çështje tjetër është edhe çështja e arsimit joformal konkretisht që parashihet në kreun e dytë të projektligjit ku mendon që duhet të ketë edhe një strategji të rinisë kundër analfabetizmit.

**Heset Cakolli** – përkrah miratimin në parim të këtij projektligji si ligj i rëndësisë së veçantë meqenëse rinia në Kosovë përbën pjesën dërmuese të popullatës.

Ky Ligj rregullon një fushë me rëndësi siq janë këshillat e rinisë, kompetencat e organeve qendrore e lokale, organizimi, fuqizimi, kushtet kriteret dhe procedurat të përkrahjes së rinisë.

**Gani Buçinca** pavarësisht disa vërejteve të vogla gjuhësore dhe teknike projektligji duhet të miratohet në parim meqë rregullon një fushë me rëndësi.

Me këtë ligj duhet të ketë vëmendje edhe ministria e arsimit dhe të definohen disa nene.

**Adem Hajdaraj**- përkrah miratimin në parim të projektligjit me me disa rekomandime gjuhësore në nenin 3 , 4, ku fjala “nenkupton “ të zëvendësohet me një fjalë tjetër

**Mark Krasniqi** përkrah miratimin në parim të projektligjit me disa ndryshime në format e organizimit të të rinjëve.

**Donika Kadaj** –tha se vërejtjet në këtë projektligj kanë të bëjnë me organizimin joformal dhe punën vullnetare të rinjëve  
Vërejtje tjetër është edhe kostoja financiare e cila është në disproporcion me një çështje tjetër ngase nuk kemi një plan të veprimit .  
Me amendamentimin e këtij projektligji do të rregullohet kjo fushë e cila ka rëndësi të madhe për rininë dhe perkrah në parim miratimin e këtij projektligji.

Komisioni konstatoi se perkrah në parim projektligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë, i cili pritet të miratohet në seancën plenarë të radhës.  
Komisioni u pajtua që referues për këtë projektligj të caktohet Arsim Rexhepi.

### **3. Të ndryshme**

Kryetari i Komisionit, propozoi që lidhur me dokumentin Letra e Bardhë të debatohet, ndërsa sugjerimet konkrete të propozohen në mbledhjen e radhës të Komisionit.

**Arsim Rexhepi** tha se Letra e Bardhe për përfshirje sociale është një dokument, i hartuar nga UNDP –ja që parasheh që do të shqyrtohet nga Komisioni për Integritet Evropian, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport dhe Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, secili sipas fushëveprimit të vetë,.  
Kjo nismë sipas tij ka të bëjë me një koncept të përfshirjes dhe identifikimit së grupeve sociale me grupet e interesit.  
Lidhur me këtë dokument kishte vërejtje lidhur me statistikat e marra nga ana e komunitetit serb të cilat i konsideron jo të sakta dhe që duhet përmirësuar.

**Fatmir Haxholli** përfaqësues nga UNDP sqaroi para Komisionit projektin e hartuar nga UNDP dhe të cilin projekt e ka mirëpritur Kuvendi i Kosovës e që ka të bëjë me identifikimin e rasteve sociale dhe përfshirjen e tyre me grupet e interesit.  
Komisionet sipas veprimtarisë së vet do të japin komentet dhe sugjerimet këtij dokumenti i cili do të shqyrtohet dhe miratohet në seancë plenare.

Anëtarët e Komisionit, perkrahën iniciativën e UNDP-së, lidhur me Letrën e Bardhë për çështjen sociale, për identifikimin e problemeve sociale në fushën e arsimit.  
Komentet dhe sugjerimet anëtarët e Komisionit lidhur me këtë dokument të do ti prezentojnë në mbledhjen e radhës.

**Gani Buçinca** tha se ka në këtë dokument ka vërejtje të natyrës gjuhësore me lëshime në perkthim.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me vizitat që do të realizohen gjatë muajve në vijim nëpër Drejtoratet e Arsimit në Komunitatet e Kosovës.  
Vizitat do të bëhen në grupe të anëtarëve të Komisionit me qëllim të informimit më të drejtpërdrejtë me zhvillimet e arsimit nëpër komuna.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11, 40

Kryetari i Komisionit,  
Agim Veliu